



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. nga shoqëria FUJITSU GENERAL(Euro) GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.712 prot., i AK, datë 09.12.2022, “Njoftim”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me blerjen e propozuar, me qëllim përfitimin e kontrollit të shoqërisë FG South East Europe S.A nga shoqëria FUJITSU GENERAL(Euro) GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: FUJITSU GENERAL(Euro) GmbH**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Prodhimin, blerjen dhe rishitjen e artikujve teknikë, veçanërisht të pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe aksesoreve të tyre përkatës, përfshirë këtu përpunimin e pjesshëm ose përpunimin e plotë, si dhe importimin ose eksportimin e tyre.

FUJITSU GENERAL(Euro) GmbH, është pjesë e grupit FUJITSU GENERAL LIMITED, Japoni, e cila operon në tregjet e prodhimit dhe shpërndarjes së kondicionerëve, sistemet e informacionit dhe komunikimit, dhe komunikimit të pajisjeve elektronike.

Grupi realizon shitje në vendet e BE-së dhe vende të treta. FUJITSU GENERAL(Euro) GmbH, nuk ka filial në Shqipëri.

**Pala shitëse: SILANER INVESTMENTS LIMITED**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas ligjeve të Qipros.

**Shoqëria Target: FG SOUTH EAST EUROPE S.A.**, është një shoqëri aksionare, e regjistruar me afat të pacaktuar, e themeluar sipas ligjeve të Greqisë, me objekt aktiviteti: Zhvillimin me mjetet e veta, prodhimin, montimin, importin, eksportin, përfaqësimin dhe asgjësimin për fitim (tregtimi) i pajisjeve elektrike si kondicionerët, pajisjet elektrike të bardha dhe pajisjet e telefonisë celulare, ofrimin e shërbimeve të hulumtimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të të sisteve informatike IT-së, etj.

Shoqëria Target nuk ka filiale në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**